

korrik 2011

gap

monitor

i vendimeve të Qeverisë së Kosovës



- Nuk ka buxhet për përmirësimin e cilësisë së ajrit
- Qeveria i kërkon Gjykatës Kushtetuese sqarimin e imunitetit të zyrtarëve të lartë publikë
- Miratohet Projektligji për vlerat e luftës së UÇK
- Blog | përse shumë biznese ende nuk e zbatojnë Ligjin e Punës?!



## Hyrje

- Gjatë muajit korrik 2011, Qeveria e Kosovës ka mbajtur pesë mbledhje të rregullta dhe një të jashtëzakonshme. Në pesë mbledhjet e rregullta janë marrë në total 39 vendime, kurse në mbledhjen e jashtëzakonshme Kryeministri ka informuar kabinetin qeveritar për zhvillimet më të fundit në pjesën veriore të Kosovës.

- Në korrik Qeveria ka miratuar 13 projektligje. Trembëdhjetë projektligjet e miratuara ngritin në 58 numrin e projektligjeve të miratuara në shtatë mujorin e 2011. Apo 39.1% e Strategjisë Legjislative 2011. Në pesë mujorin e mbetur, Qeverisë i duhet të kaloj edhe 90 projektligje, nëse synohet zbatimimi në tërësi i strategjisë legjislative. Shumica e projektligjeve të miratuara gjer tani nuk kanë respektuar afatet kohore të parapara në Strategjinë Legjislative. Kjo më së shumti ka ndikuar në planin e Punës së Kuvendit të Kosovës. (për më shumë shih shkrimin e plotë për Strategjinë Legjislative).

- Në mesin e projektligjeve të miratuara janë edhe Projektligji për Qendrën Historike të Prizrenit dhe Projektligji për Vlerat e Luftës së UÇK. Projektligji për Qendrën Historike të Prizrenit është një nga ligjet e pakta të mbetura nga Pakoja e Ahtisaarit. Draftimi dhe përmbajtja e projektligjit janë mbajtur sekret nga publiku. Me anë të këtij ligji Qendra Historike e Prizrenit do të qeveriset nga një trup i veçantë jashtë komunal. (Raportin më të plotë për përmbajtjen e Projektligjit për Qendrën Historike të Prizrenit mund ta lexoni në brendi të GAP Monitor). Në anën tjetër, Qeveria e Kosovës, e gjendur nën presionin e organizatave të dala nga lufta, ka miratuar Projektligjin për vlerat e luftës së UÇK. Mirëpo sfida mbetet qartësimi i listave për përfituesit nga ky ligj, në mungesë të listave të sakta të ish pjesëtarëve të UÇK. (Lexo raportin me titull “Miratohet Projektligji për vlerat e luftës së UÇK” në brendi të këtij numri).

- Këtë muaj janë përzgjedhur edhe gjashtë sekretar të përgjithshëm të ministrive. Deri në fund të korrikut, janë përzgjedhur 13 nga 19 sekretarët e përgjithshëm të ministrive. Ky proces është zhvilluar në formë jo transparente dhe me ndërhyrje politike duke vështirësuar edhe më tutje profesionalizmin dhe pavarësinë nga ndërhyrjet politike në shërbimin civil. Edhe pse ka ekzistuar konkursi publik, postin e sekretarit të përgjithshëm e kanë fituar të gjithë ata që kanë qenë ushtrues detyre në këto pozita, të vendosur me vendime politike. Në mesin e anëtarëve të përzgjedhur gjenden anëtar të partisë politike në pushtet (PDK) apo persona për të cilat janë hapur hetime nga EULEX (lexo raportin e plotë në brendi të GAP Monitor).

- Qeveria ka miratuar Raportin Gjashtëmujor të Buxhetit 2011. Raporti paraqet performancë të mirë për këtë periudhë sa i përket të hyrave buxhetore. Mirëpo, në anën tjetër, Qeveria ka marrë masa që të ngrij disa shpenzime deri në shitjen e PTK, për shkak të rrezikut të deficitit buxhetor. Për herë të parë që kur institucionet vendore kanë përgjegjësinë për hartimin dhe implementimin e buxhetit shtetëror, nuk do të ketë rishikim të ligjit për buxhetin. Në anën tjetër, Ligji për Buxhetin 2011 ka pësuar ndryshime rrënjësore. Sipas Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike, në rastet kur buxheti ka ndryshime të mëdha nga ai i miratuar fillimisht, Qeveria duhet të dorëzoj në Kuvend Projektligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Buxhetin. Kjo nuk ka ndodhur këtë vit.

- Qeveria ka dështuar të aprovoj Strategjinë dhe Planin e Veprimit për Cilësinë e Ajrit. Gjatë kësaj periudhe shtatë mujore Qeveria ka marrë vendime të ndryshme që indirekt ndikojnë në rëndimin e cilësisë së ajrit, siç është vendimi për akcizën e automjeteve të vjetra deri 13 vjet, projektet energjetike në vend, etj. Në anën tjetër, Qeveria ka konsideruar se mungojnë mjetet buxhetore për zbatimin e Planit të Veprimit për Cilësinë e Ajrit 2011-2015. Kostoja buxhetore për zbatimin e këtij plani është 300 milion Euro. Në anën tjetër, mos aprovimi i planit ndikon edhe në mos zbatimin e ligjeve dhe akteve nënligjore nga fusha e mbrojtjes së cilësisë së ajrit dhe mjedisit. (Për më tepër lexo shkrimin “Kosova pa buxhet për përmirësimin e cilësisë së ajrit” në brendi të GAP Monitor).

- Edhe më tutje, qasja në informata dhe dokumente zyrtare në nivel të ekzekutivit mbetet e vështirë. Qasja në informacione nuk është konform Ligjit nr.03/L-215 për Qasjen në Dokumente Publike dhe Rregullores Qeveritare nr.03/2011 për Shërbimin e Komunikimit Qeveritar me Publikun. Institucionet ekzekutive nuk publikojnë draftet e dokumenteve të miratuara, edhe pas parashtrimit të kërkesave për qasje në dokumente publike. Në të shumtën e rasteve mënyra më efikase për sigurimin e këtyre dokumenteve është në mënyre jo formale. Asnjë zyre për informim me publikun, nuk funksion sipas Rregullores Qeveritare për Shërbimin e Komunikimit Qeveritar dhe realizimi i kërkesës për qasje në dokumente publike më së vështiri realizohet pikërisht nga këto zyre. Në uebfaqen e GAP Monitor mund të shkarkoni 18 nga 20 dokumentet e miratuara gjatë muajit korrik. Raportet individuale për të gjitha vendimet e marra gjatë muajit korrik 2011 mund ti gjeni edhe në portalin e GAP Monitor në internet [www.gapmonitor.org](http://www.gapmonitor.org).

## Përmbajtja

---

Pa buxhet për përmirësimin e cilësisë së ajrit

4

Miratohej edhe 13 projektligje

7

Miratohej Projektligji për Qendrën Historike të Prizrenit

9

Miratohej Projektligji për vlerat e luftës së UÇK

10

Miratohej Raporti Gjashtëmujor i Buxhetit 2011

11

Miratohej Korniza e Politikave të Zhvendosjes për banorët e Zonës së Mihjes së Re

13

Qeveria kërkon nga Gjykata Kushtetuese sqarimin e imunitetit për zyrtarët e lartë publikë

14

Deri në fund të korrikut janë përzgjedhur 13 nga 19 sekretarët e përgjithshëm të ministrive

15

Miratohej Plani Zhvillimor Strategjik i MMPH

16

Miratohej Strategjia Kombëtare për Sigurinë në Bashkësi dhe Plani i Veprimit 2011-2016

17

Blog | Përse shumë biznese private ende nuk e zbatojnë Ligjin e Punës?!

20

PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË KORRIKUT 2011

22



## Pa buxhet për përmirësimin e cilësisë së ajrit

**C**ilësia e ajrit dhe mbrojtja e mjedisit janë sfida të cilat Kosova nuk po arrin ti vëre nën kontroll. Një përpjekje për të vendosur rregull në përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe në mbrojtjen e mjedisit u vërejt në mbledhjen e 24 të Qeverisë, mbajtur më 20 korrik 2011. Në këtë mbledhje ishin caktuar tri pika të rendit të ditës që kanë të bëjnë me ajrin dhe mjedisin: Miratimi i Udhëzimi Administrativ për Normat e Cilësisë së Ajrit, Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Cilësinë e Ajrit dhe Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin.

Kosova konsiderohet si një nga vendet me cilësinë më të dobët të ajrit në rajon. Ndotja më e madhe vije nga termocentralet, gazrat e automjeteve, pluhuri, etj. Në 2004, Kuvendi i Kosovës për herë të parë aprovoi Ligjin për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja. Ky ligj u zëvendësua me një ligj të ri në 2010 – Ligji nr.03/L-160 për

Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja. Ky ligj ka për qëllim të rregulloj dhe garantoj të drejtën e qytetarëve për të jetuar në një mjedis me ajër të pastër, duke mbrojtur

Përkundër asaj se ekziston bazë ligjore për mbrojtjen e ajrit dhe mjedisit, në mungesë të mjeteve buxhetore këto ligje kanë mbetur të pa zbatuara

shëndetin e njeriut, faunën, florën dhe vlerat natyrore e kulturore të mjedisit.

### Ligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja

Ligji nr.03/L-160 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja vë bazat ligjore të rregullimit të kësaj fushe, kurse pjesa më e rëndësishme e rregullativës ligjore mbetet të përfundohet me akte nënligjore. Ligji ka gjithsejtë 42 nene dhe më shumë se gjysma prej tyre, apo 22 nene, parashohin nxjerrjen e akteve të veçanta për plotësimin e Ligjit. Aktet nënligjore të parapara me Ligj duhet të nxirren

brenda 18 muajve nga data e hyrjes së Ligjit në fuqi. Ligji ka hyrë në fuqi në mars 2011, apo 17 muaj më parë.

### Nxjerrja e akteve nënligjore

Qeveria e Kosovës ka nxjerrur dy akte nënligjore të cilat plotësojnë Ligjin për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja. Më 2 shtator 2010 ka hyrë në fuqi Udhëzimi Administrativ nr.15/2010 për Kriteret për Përcaktimin e Pikave Monitoruese për Cilësinë e Ajrit, Numrin dhe Shpeshtësinë e Matjeve, Klasifikimin e Ndotësve të cilët Monitorohen, Metodologjinë e Punës, Formën dhe Kohën e Raportimit të të Dhënave. Kurse më 20 korrik 2011, në mbledhjen e 24 të qeverisë, u miratua edhe Udhëzimi Administrativ për



### Normat e Cilësisë së Ajrit.

Këto dy udhëzime administrative plotësojnë pikat më të rëndësishme ta parapara me Ligj. Por, asnjëri nga ta, edhe më tutje, nuk janë të publikuara në faqen zyrtare të MMPH, të Kryeministrit apo në Gazetën Zyrtare.

Përderisa Qeveria e Kosovës vazhdon me marrjen e vendimeve të cilat ndikojnë negativisht në cilësinë e ajrit (kapacitetet e reja gjeneruese të energjisë, lejimi i qarkullimit të automjeteve të vjetra, etj.), nuk është bërë asgjë në drejtim të përmirësimit të cilësisë së ajrit

### Informimi i Publikut për Cilësinë e Ajrit

Me Ligj por edhe me Udhëzimin Administrativ për Normat e Cilësisë së Ajrit, MMPH obligohet që të informoj publikun me të dhënat për cilësinë e ajrit. Deri më tani nuk ekziston asnjë raport publik me të gjeturat për cilësinë e ajrit dhe në këtë aspekt Qeveria nuk ka arritur të zbatoj Ligjin.

### Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin

Duke u bazuar në Ligjin nr.03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës, Qeveria e Kosovës ka miratuar Strategjinë për Biodiversitetin 2011-2020 dhe Planin e Veprimit për Biodiversitetin 2011-2015. Këto

dy dokumente avancojnë edhe më tutje mbrojtjen e ambientit. Strategjia vendos katër objektiva strategjike deri më 2020: 1. Zhvillimi i kornizës ligjore dhe institucionale sipas standardeve të BE-së dhe zbatimi efektiv i sajë; 2. Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i gjendjes së llojeve të bimëve dhe shtazëve, vendbanimeve natyrore dhe

peizazheve reprezentative në baraspeshë natyrore; 3. Sigurimi i mbrojtjes së integruar të natyrës përmes bashkëpunimit me sektorët tjerë, shfrytëzimi i qëndrueshëm i biodiversitetit dhe ndarja e barabartë e përfitimeve; 4. Promovimi i edukimit dhe komunikimit efektiv për biodiversitetin.

Plani i veprimit është miratuar për periudhën pesë vjeçare dhe buxhetit të Kosovës do ti kushtoj rreth 50 milion euro. Ministria e Financave ka tërhequr vërejtjen se kjo kosto buxhetore mund të paraqes problem për qeverinë. Megjithatë, Qeveria ka miratuar këto dy dokumente të rëndësishme për mbrojtjen e mjedisit.

### Strategjitë dhe Planet e Veprimit për Cilësinë e Ajrit

Ligji për Mbrojtjen e Cilësisë së Ajrit, me qëllim të zbatimit praktik të normave ligjore dhe përmirësimin e

cilësisë së ajrit, parasheh edhe nxjerrjen e strategjive dhe planeve të veprimit, si dhe hartimin e raporteve për zbatimin e planeve të veprimit.

Cilësisë së Ajrit 2011-2020 rikonfirmon se cilësia e ajrit në Kosovë është në gjendje jo të mirë. Disa nga ndotësit më të mëdhenj të ajrit janë

shtrirjen e rrjetit për monitorim të cilësisë së ajrit dhe pikat për monitorim pritet të finalizohen brenda vitit 2011. Përkundër këtyre shqetësimeve për cilësinë e ambientit, përkundër fakteve të paraqitura se cilësia e ajrit është dukshëm më e ndotur se sa pranohet me standardet e BE, prapë se prapë Qeveria nuk ka miratuar strategjinë dhe Planin e Veprimit për Cilësinë e Ajrit.

Në anën tjetër, Qeveria e Kosovës ka marr vendime të shumta të cilat rëndojnë cilësinë e ajrit, siç janë zgjerimi i mihjeve

Qeveria nuk ka miratuar Strategjinë dhe Planin e Veprimit me arsyetimin se kostoja financiare për 5 vitet e ardhshme kap një vlerë prej 300 milion euro

Në mbledhjen e 24, MMPH paraqiti për miratim Strategjinë për Mbrojtjen e Cilësisë së Ajrit 2011-2020 dhe Planin e Veprimit për periudhën 2011-2015. Qeveria nuk miratoi Strategjinë dhe Planin e Veprimit me arsyetimin se Plani i Veprimit për periudhën 5 vjeçare mbart një kosto financiare prej 300 milion Euro dhe kjo është e papërbalueshme për buxhetin e shtetit.

Strategjia për Mbrojtjen e

KEK, Sharrcem, Ferronikeli, ku emisionet e liruara në ajër nga to, tejkalojnë kufijtë e lejuar. Gjithashtu, sipas asaj që konfirmohet me Strategji, rritja e numrit të automjeteve ka ndikuar

Plani i Veprimit për Biodiversitetin do t'i kushtojë buxhetit të Kosovës 50 milion Euro për pesë vitet e ardhshme

në uljen e cilësisë së ajrit. Analizat e gjertanishme të cilësisë së ajrit konfirmojnë mos përputhje me standardet e BE. MMPH ka filluar

të reja të linjtit, ndërtimi i kapaciteteve të reja energjetike, lejimi i automjeteve të vjetra që të qarkullojnë në Kosovë, etj.

## Fillon parimi i reciprocitetit në marrëdhëniet tregtare me Serbinë dhe Bosnjën e Hercegovinën

**N**ë mbledhjen e saj të 24-të, të mbajtur më 20 korrik, Qeveria e Republikës së Kosovës ka mbështetur vendimin e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë për vendosjen e masave të reciprocitetit në marrëdhëniet tregtare me Serbinë dhe Bosnjën e Hercegovinën. Sipas vendimit të Ministrisë, i cili ka hyrë në fuqi po të njëjtën ditë, pra më 20 korrik, nuk do të njihen më vulat doganore dhe të administratës tatimore të Republikës së Serbisë. Kjo do të thotë se me këtë vendim ndalohet importi i të gjithë mallrave që përmbajnë këto vula. Po ashtu me këtë vendim nuk do të njihen më vulat doganore edhe të Bosnjës dhe Hercegovinës, kurse për mallrat që përmbajnë këtë vulë vendosen taksa doganore

prej 10%. Duhet sqaruar se ky është një vendim i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, i cili u përshëndet nga Qeveria, por nuk u hodh në votim nga ana e Kryeministrit për të dalë më pas si vendim i zakonshëm i Qeverisë së Kosovës.

Vendosja e masave të njëjta tregtare me këto dy shtet mund të konsiderohet si një veprim i duhur por i vonuar. Duhet përmendur se që nga 4 dhjetori

Në mars 2011, Instituti GAP pat publikuar një analizë ku i bën thirrje Qeverisë së Kosovës që të dalë nga status quoja sa i përket marrëdhënieve tregtare me këto dy shtete. Për shkak të humbjeve të mëdha tregtare që po vinin si pasojë e mos aplikimit të marrëveshjes së CEFTA-s nga ana e Serbisë dhe Bosnjës, GAP i kishte rekomanduar Qeverisë që të vendos masa provizore ri-balancuese, pra t'i rris tarifat

Ky është vendim i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, i cili u përshëndet nga Qeveria, por nuk u hodh në votim nga ana e Kryeministrit

2008 kur Kosova ndryshoi vulat doganore nga Doganat e UNMIK-ut në Dogana e Kosovës, Serbia dhe Bosnja kanë ndaluar eksportin e produkteve kosovare duke mos lejuar as kalimin transit nëpër territoret e tyre.

doganore për produktet që vinin nga Serbia dhe Bosnja në mënyrë që të ri-balancoheshin humbjet e shkaktuara nga këto dy shtete. Analizën e plotë mund ta lexoni në <http://www.institutigap.org/?cid=1,5,178>.



## Miratohen edhe 13 projektligje

**G**jatë muajit korrik, në pesë mbledhjet e mbajtura, Qeveria e Kosovës ka miratuar 13 projektligje nga Strategjia Legjislative 2011. Projektligjet e miratuara janë: 1. Mbrojtjen e

e Pasurisë së Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave; 8. Marrëveshjet Ndërkombëtare; 9. Akademinë e Kosovës për Siguri Publike;

Modifikuar Gjenetikiisht.

Me këto 13 projektligje, numri i projektligjeve të miratuara në shtatë mujorin e parë të 2011 ka arritur në 58. Strategjia Legjislative e 2011 përmban 148 projektligje. Në pesë muajt e mbetur, Qeverisë i duhet të miratoj edhe 90 projektligje për të përbushur strategjinë legjislative.

Tabela më poshtë pasqyron 13 projektligjet e miratuara në korrik, datat e miratimit të tyre në Qeveri, afatet kohore të parapara me SL'11 dhe afatet kohore të parapara me Planin e Punës së Kuvendit të Kosovës për 2011.

Nëse synohet përbushja e Strategjisë Legjislative 2011, Qeveria duhet të miratojë edhe 90 projektligje në pesë muajt në vazhdim

Informatorëve; 2. Zjarrfikje dhe Shpëtim; 3. Tregti me Jashtë; 4. Masa Mbrojtëse në Importe; 5. Partneritetin Publiko Privat; 6. Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik; 7. Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin

10. Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjarëve të tyre; 11. Qendrën Historike të Prizrenit; 12. Lirinë e Asociimit në OJQ; dhe 13. Organizmat e

Strategjia Legjislative 2011 148 projektligje		
janar-qershor 45	korrik 13	për t'u miratuar: gusht-dhjetor 90
39,1%		60,9%

Projektligji për:	Dërgimi në ZSHNJ ashtu siç parashihet me SL'11	Miratimi në Qeveri	Plani i Punës së Kuvendit të Kosovës 2011	
			Leximi i I	Leximi i II
Mbrojtjen e Informatorëve	31.5.2011	6.7.2011	7/2011	9/2011
Zjarrfikje dhe Shpëtim	31.3.2011	6.7.2011	5/2011	7/2011
Tregti me Jashtë	30.6.2011	6.7.2011	7/2011	10/2011
Masa Mbrojtëse në Importe	30.6.2011	6.7.2011	7/2011	10/2011
Partneritetin Publiko Privat	31.5.2011	6.7.2011	7/2011	10/2011
Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik	31.5.2011	13.7.2011	7/2011	10/2011
Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë së Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave	31.5.2011	13.7.2011	7/2011	10/2011
Marrëveshjet Ndërkombëtare	31.5.2011	13.7.2011	7/2011	10/2011
Akademine e Kosovës për Siguri Publike	30.6.2011	13.7.2011	7/2011	10/2011
Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjarëve të tyre	31.5.2011	22.7.2011	7/2011	10/2011
Qendrën Historike të Prizrenit	30.4.2011	27.7.2011	7/2011	10/2011
Liriinë e Asociimit në OJQ	31.5.2011	27.7.2011	7/2011	10/2011
Organizmat e Modifikuar Gjenetik	30.4.2011	27.7.2011	7/2011	09/2011

Siç mund të shihet nga kjo tabelë, Projektligji për Zjarrfikje dhe Shpëtim do të duhej që në korrik të miratohej në Kuvend, mirëpo dështimi i Qeverisë për të dorëzuar me kohë projektligjin në Kuvend, ka bërë që Kuvendi të mos mund të zbatoj planin e tij të punës sipas afateve kohore të parapara.

Dymbëdhjetë nga trembëdhjetë projektligjet e miratuara në Qeveri,

Kuvendi i ka paraparë që ti kaloj në lexim të parë gjatë muajit korrik. Mirëpo, sërish, për shkak të vonesave të Qeverisë, këto projektligje nuk kanë mund të futen në procedurë në Kuvend, ashtu siç Kuvendi i Kosovës e ka paraparë me planin e tij të punës.





## Miratohet Projektligji për Qendrën Historike të Prizrenit

Më 27 korrik 2011, në mbledhjen e 26 të Qeverisë së Kosovës, është miratuar Projektligji për Qendrën Historike të Prizrenit. Ky ligj parashihet edhe ma Pakon e Ahtisaarit dhe është njëri nga dy ligjet të cilat nuk janë miratuar ende. Ligji tjetër është ai për Hoqën e Madhe, i cili është pjesë e

zone ndodhen 104 objekte dhe katër komplekse arkitekturale.

Sipas këtij projektligji, ndërtimet, aktivitetet rekreative, shërbimet komunale, hapësirat reklamuese, etj., duhet të rregullohen në mënyrë të veçantë, nga një organizëm i ri i krijuar nga komuna, por i cili përbëhet nga komunitetet fetare,

Nga terminologjia e përdorur shihet se objektet fetare ortodokse janë klasifikuar si objekte serbe, përderisa objektet fetare të dy religjioneve tjera nuk lidhen me ndonjë kombësi. Gjithashtu, sipas projektligjit, anëtarët e bashkësive fetare nuk dallohen nga anëtarët e shoqërisë civile. Qeveria e Kosovës ka ën proces miratimit e Ligjit për Bashkësitë Fetare, i cili do të krijoj status të veçantë për bashkësitë fetare, nga ai i OJQ-ve.

Ky është njëri nga dy projektligjet nga Pakoja e Ahtisaarit që ende nuk janë miratuar

Strategjisë Legjislative të 2011.

Miratimi i këtyre dy ligjeve është shtyrë nga viti në vit, për shkak të ndjeshmërisë së tyre. Shoqëria civile në Prizren ka kërkuar disa herë përfshirjen në hartimin e këtij projektligji, mirëpo pa sukses. Drafti i tij është mbajtur fshehur nga publiku.

Projektligji për Qendrën Historike të Prizrenit përfshin 1,377 zona kadastrale në qendrën e Prizrenit dhe 141 zona kadastrale në zonën e Kalasë. Në total brenda kësaj

komunitetet etnike dhe shoqëria civile. Ky trup do të quhet Komiteti për Trashëgiminë Kulturore të Prizrenit dhe do të përbëhet nga shtatë anëtarë. Gjashtë anëtarë do të përzgjidhen nga shoqëria civile dhe komunitetet fetare, sipas kësaj ndarje: një anëtar nga Bashkësia Islami, një nga Kisha Ortodokse Serbe dhe një nga Kisha Katolike; tre anëtarë nga shoqëria civile. Anëtari i shtatë do të përzgjidhet nga strukturat komunale, saktësisht nga Zyra Komunale për Komunitete.

Sipas Projektligjit, ndalohet bashkimi i dy apo më shumë parcelave kadastrale në një njësi të vetme; aktivitetet ndërtimore apo transformuese që rezultojnë me ngritjen e një objekti të vetëm në dy apo më shumë parcela kadastrale; ndërtimi i objekteve më shumë se dy katëshe (përdhes + 2 kate); ndërtimi i objekteve me bazë më të madhe se 150m<sup>2</sup>; aktivitetet

që do të rezultonin në ndryshimin permanent të morfologjisë natyrore të terrenit; etj.

prek pronat e Kishës Ortodokse Serbe në Qendrën Historike të Prizrenit në pajtim me Aneksin 5

të barabartë të gjitha komunitetet fetare, neni 18.4, i jep një zë shtesë Kishës Ortodokse.

Mbrojtja e objekteve dhe hapësirave të trashëgimisë kulturore është e rregulluar edhe me Ligjin për Trashëgiminë Kulturore, Ligjin për Zonat e Veçanta të Mbrojtura dhe Ligjet për planifikim hapësinor

Ligjet e mëhershme nga Pakoja e Ahtisaarit janë miratuar me procedurë të përsheptuar në Kuvend. Deputetët e Kuvendit të Kosovës dhe ICO, kanë bërë të qartë se pas kalimit të periudhës transitore 120 ditore (shkurt-qershor 2008), nuk ndihet nevoja e miratimit të ligjeve në procedurë të përsheptuar.

Gjithashtu, sipas nenit 18 pika 4, Komiteti duhet të kërkojë pajtimin e Kishës Ortodokse Serbe për çdo aktivitet, i cili

të Propozimit Gjithëpërfshirës të Zgjidhjes dhe Kushtetutën.

Edhe pse në dukje të parë lihet përshtypja se ky ligj konsideron

## Miratohet Projektligji për vlerat e luftës së UÇK

Në mbledhjen e 25 të Qeverisë së Kosovës, më 22 korrik 2011, është miratuar Projektligji për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjarëve të tyre, apo siç ka filluar të njihet me emërtimin "Ligji për Vlerat e Luftës së UÇK".

Ky Projektligj është pjesë e strategjive legjislative të Qeverisë që nga viti 2009. Më 27 korrik 2009 Qeveria e Kosovës përfshiu këtë projektligj në Strategjinë Legjislative 2009. I njëjti u bart edhe në Strategjinë Legjislative 2010, ku edhe u miratua më 5 gusht 2010. Për shkak të krizës institucionale që qoi në zgjedhjet e parakohshme parlamentare, Ligji për vlerat e luftës nuk arriti

të miratohet dhe iu kthye mbrapa Qeverisë për riprocedim.

Projektligji për vlerat e luftës u përfshi në Strategjinë Legjislative 2011 dhe sipas afateve kohore të parapara në këtë strategji, Projektligji do të duhej të miratohej në qershor të këtij viti. Qeveria e Kosovës kishte përfshirë në rend

**Kostoja financiare e këtij Projektligji pritet të jetë 4,8 milionë Euro**

dite miratimin e Projektligjit për në seancën e 20 qershorit 2011, mirëpo mbledhja u anulua për shkak të vdekjes së deputetes Nekibe Kelmendi.

Projektligji nuk u përfshi pastaj në rendin e ditës për 5 mbledhjet që rodhën pas saj. Arsyetimi për

këtë shtyrje ishte se Qeveria është duke negociuar me FMN për koston financiare të këtij ligji.

Sipas Kryeministrit, ky akt ligjor është një nga projektligjet më të qëlluara që Qeveria e Kosovës ka miratuar, si dhe është një nga ligjet më të avancuara në rajon i cili mbron kategoritë e dala nga lufta.

Qeveria është shprehur se Projektligji i miratuar në mbledhjen e 25 të Qeverisë, nuk ndryshon nga ai i miratuar më 5 gusht 2010.

Vitin e kaluar, me rastin e dërgimit të Projektligjit në Kuvend, Qeveria kishte përfshirë edhe Vlerësimin e Ndikimit Buxhetor. Sipas këtij vlerësimi, Projektligji për vlerat e luftës përmban një kosto shtesë buxhetore prej 4,8 milion Euro në vit.

Kosto buxhetore është e lidhur kryesisht me rritjen e numrit të përfituesve dhe rritjen e niveleve të përfitimit të marra nga këta përfitues:

- Numri i përfituesve aktual të pensioneve të invalidëve të luftës sipas projektligjit është vlerësuar të rritet në 13,573 nga numri aktual prej 12,522.
- Sipas projektligjit disa kategori do të përfitojnë pensione më të larta, ndërsa disa kategori do të kenë zbritje të pensionit;
- Numri i pensioneve të reja është 1051 i përbërë nga 450 familje të dëshmorëve, 312 kanë të bëjnë me rritjen e skemave ekzistuese të pensioneve, 250 për njerëzit e zhdukur të cilët kalojnë në kateorinë e viktimave civile dhe 39 i përkasin kateorisë së të humburve civil.

Duke përdorur supozimet e lartpërmendura , llogaritjet rezultojnë në një kosto shumë të lartë prej 4,800,000 si në vijim:

- Civil të zhdukur, prej 44,000 euro (39 pensione me 139 euro)
- Kategorinë e familjeve viktimave civile që përfshinë 250 pensione me kosto prej 400,000 euro në vit;
- Pjesa tjetër e shpenzimeve buxhetore prej rreth 3,600,000 euro përfaqësojnë efektin e rritjes aktuale të përfituesve, kategoritë e reja që do të përfitojnë( si dëshmorët e kombit, 450 persona do të përfitojnë pensionin prej 286 euro);
- Rritje të pensioneve të invalidëve të luftës në 2010, të vlerësuar prej 1,600,000 Euro;
- Për shkak të të vdekurve në kategorinë e pensionit , ka kursime ose zvogëlime të kostos buxhetore prej rreth 840,000 euro.

Sipas Kryeministrit, i cili ka prezantuar këtë projektligj në mbledhjen e Qeverisë, FMN ka dhënë pëlqimin për aprovimin e këtij

listave të veteranëve, pjesëtarëve, invalidëve dhe dëshmorëve të UÇK nuk është bërë ende, edhe pse më 22 prill 2010, me vendimin

Organizatën e Veteranëve të UÇK, përfaqësuesit e të gjithë ish-Zonave Operative të UÇK, përfaqësues të Zyrës së Kryeministrit dhe përfaqësues të ish-TMK-së. Po sipas vendimi, komisioni do të duhej të përfundonte punën brenda vitit 2010.

Duke harruar se një komision verifikues ad-hoc është krijuar tani më, Kryeministri i Kosovës në mbledhjen e 22 korrikut 2011, kërkoi edhe një herë krijimin e komisioneve për verifikimin e listave.

Nëse bazohemi në procedurat të punës së Kuvendit të Kosovës, Projektligji do të kaloj leximin e parë në Kuvend gjatë shtatorit, kurse do të miratohet në nëntor të këtij viti.

Në prill të vitit të kaluar Qeveria kishte themeluar një Komision ad-hoc për verifikimin e listave të pjesëtarëve të UÇK, mirëpo ky komision ende nuk ka dalë me të dhëna të sakta për numrin e ish-pjesëtarëve, dëshmorëve, invalidëve dhe veteranëve të UÇK

ligji. Ky ligj nuk pritet të hyj në fuqi këtë vit, por nga janari i 2012.

Kalkulimi i koston buxhetore mbetet i vështirë, për faktin se nuk ekzistojnë lista të sakta të ish pjesëtarëve të UÇK, etj. Verifikimi i

04/121, Qeveria kishte formuar një Komision ad-hoc për verifikimin e listave. Sipas vendimit të Qeverisë, ky komision do të përbëhej prej 11 vetash të cilët do të përfaqësojnë: ish-Shtabin e Përgjithshëm të UÇK,

## Miratohet Raporti Gjashtëmujor i Buxhetit 2011

Më 27 korrik 2011, në mbledhjen e 26, Qeveria e Kosovës ka aprovuar Raportin Gjashtëmujor të Buxhetit 2011. Sipas Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike, Qeveria është e obliguar që të përpiloj raportetremujorepërshpenzimet e buxhetit. Madje, me presion të Komisionit Evropian, Qeveria është pajtuar që nga fillimviti 2011 të publikoj raportet çdo muaj, mirëpo një gjë e tillë nuk ka ndodhur.

Në këtë gjashtëmujor të hyrat

e planifikuara janë realizuar 46% e planit vjetor, respektivisht 579 milion euro, e që nëse e krahasojmë me të njëjtën periudhë të vitit 2010 kemi një rritje prej 9%. Kjo nënkupton se grumbullimi i të hyrave është më e lartë këtë vit. Të hyrat nga Dogana dhe nga ATK-ja janë nga 20% më të larta krahasuar me vitin 2010. Edhe të hyrat jo tatimore kanë shënuar rritje në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Këto të hyra janë 45 milion euro apo 13%

më shumë se një vit më parë. Të hyrat vetanake komunale në këtë gjashtëmujor janë 13% më të larta krahasuar me vitin e kaluar. Si të hyrë buxhetore në këtë periudhë është edhe dividenda prej 40 milion euro nga PTK dhe 5 milion euro nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës "Adem Jashari".

Në anën tjetër, shpenzimet nuk janë kryer sipas planit buxhetor. Në gjashtëmujorin e parë

të 2011 shpenzimet janë realizuar në masën 35%. Në kategorinë paga dhe rroga shpenzimet për këtë muaj janë për 1% më ta larta krahasuar me të njëjtën periudhë në vitin 2010, respektivisht këtë vit

me periudhën e njëjtë të vitit 2010. Sipas tabelës së pranimeve dhe pagesave për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2011 kemi rritje të të hyrave krahasuar me pagesat për 49.44 milion euro dhe gjendja e mjeteve

fituesit të tenderit për privatizimin e PTK-së. Sipas vendimit të Qeverisë këto fonde do të grumbullohen nga shkrutimet buxhetore nëpër kategori të ndryshme, kështu 8 milion euro do të merren nga kategoria mallra e shërbime, 37 milion euro nga kategoria investimet kapitale, ndërsa 15 milion euro nga kategoria të tjera, respektivisht shuma e cila ishte e planifikuar t'i jepet KEK-ut në formë kredie.

## Qeveria nuk ka aprovuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Buxhetin 2011, ashtu siç parashihet me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike

janë shpenzuar gjithsejtë 148 milion euro. Në kategorinë mallra dhe shërbime shpenzimet janë për 8% më të ulëta krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Rritjen më të madhe të shpenzimeve gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2011 e hasim në kategorinë shpenzime kapitale në shumë prej 58 milion eurove, një rritje prej 55% krahasuar

në llogarinë bankare të BRK-së deri me 30 qershor 2011 është 339.15 milion euro.

Qeveria në mbledhjen e fundit mori gjithashtu vendim për ndarjen e mjeteve në shumën prej 60 milion eurove, e cila ka qenë rekomandim i FMN-së. Kjo shumë duhet të mbahet si rezerve dhe të mos shpenzohet para shpalljes së

Megjithatë edhe pse Qeveria po mer vendime bazuar në marrëveshjen e FMN, kjo marrëveshje tashmë është e suspenduar pas rritjes së pagave nga Qeveria e cila ishte kundër marrëveshjes me FMN dhe e cila rezultoi në ndaljen e kështit të kredisë, që FMN ishte dashur t'ia lëshoj Qeverisë më 31 mars të këtij viti.

## Rifillon punën Komisioni për Menaxhimin e Fondit për Mbështetje të Mediave Minoritare, Multietnike dhe Grupeve të Tjera të Veçanta

Në mbledhjen e 27-të, mbajtur më 20 korrik 2011, me vendimin 03/24, Qeveria e Kosovës ka emëruar Komisionin për Menaxhimin e Fondit për Mbështetje të Mediave Minoritare, Multietnike dhe Grupeve Tjera të Veçanta. Funkzionimi i këtij komisioni parashihet edhe me Rregulloren nr.01/2008 për

Funksionimin e Fondit për Mbështetjen e Medieve Minoritare, Multietnike dhe Grupeve Tjera të Veçanta, e miratuar nga Qeveria më 3 dhjetor 2008. Anëtar të këtij fondi do të jenë përfaqësues nga Zyra

e Kryeministrit për Komunikim me Publikun, Ministria për Komunitete dhe Kthim, Komisioni i Pavarur i Mediave, Këshilli i Mediave të Shkruara, IREX, Instituti i Medias dhe redaksia e programeve për minoritete në RTK. Komisioni do të mbështetet nga Sekretaria për Menaxhimin e Fondit, e cila do të

funksionoj në kuadër të Zyrës së kryeministrit për Komunikim me Publikun.

Ky komision, shpall konkurs ku bën thirrjen për dorëzimin e projekteve për financim dhe ndarja e mjeteve nga Fondi bëhet në bazë të projekteve të dorëzuar nga mediat minoritare, multietnike dhe grupeve

Për shkak të problemeve financiarë të RTK, Fondi për mediat minoritare nuk ishte ndarë në 2010. Në 2009 ky fond ishte 200,000 euro dhe i ishte ndarë 17 medimeve

tjera të veçanta (Për të kuptuar më shumë për kushtet e parapara me këtë konkurs, lexoni GAP Monitor Shkurt 2009, faqe 17).

Fondi i destinuar për këtë qëllim mbushet nga RTK, ku 5% e të hyrave të RTK ndahen për mbështetjen e medieve minoritare, multietnike dhe grupeve tjera të veçanta. Për herë

të parë komisioni është themeluar dhe ka funksionuar në vitin 2009. Më 30 janar 2009, me vendimin 03/52, Qeveria kishte themeluar këtë komision, ku në përbërjen e tij ishin përfaqësues nga po të njëjtat institucione të përzgjedhura tani më 2011 (Për të kuptuar më shumë për atë vendim, lexo GAP Monitor Janar 2009, faqe 10). Në vitin 2010 Qeveria nuk ka ndarë fond për këto media, me arsyetimin se RTK ka vështirësi për të financuar programet e saja.

Në vitin 2009, Fondi k ishte në dispozicion 200,000 Euro. Në 2009, këtij komisioni i ishin dashur 7 muaj për të vendosur për mediat përfituese. Lista e medieve përfituese nga ky fond ishte bërë publike më 8 tetor 2009, me vendimin e Qeverisë 04/86. Përfitues të atëhershëm ishin 17 media dhe shuma maksimale e ndarë për një medium ishte 15,000 Euro.



## Miratohet Korniza e Politikave të Zhvendosjes për banorët e Zonës së Mihjes së Re

Në mbledhjen e 22-të, mbajtur më 6 korrik 2011, Qeveria e Kosovës me vendimin 09/22 miratoi Kornizën e Politikave të Zhvendosjes për Zonën Fusha e Mihjes së Re. Dy vite më parë, më 13 mars 2009, Qeveria e Kosovës e shpalli zonën e Mihjes së Re si zonë

në parimet e Bankës Botërore për zhvendosjen e popullsisë. KPZh për Zonën e Mihjes së Re është dokument i cili vë bazat për zhvendosjen e banorëve nga territori ku do të shfrytëzohen resurset natyrore për ndërtimin e Kosovës C. KPZh pranon faktin se

ambient të ri), kulturore, etj.

Korniza e Politikave të Zhvendosjes nuk përmban afate kohore, por kjo i lihet të vendoset për çdo plan të veprimit për zhvendosje (PVZH-ve), varësisht nga dinamikat e projektit. Orari kohor dhe buxheti përafërt për Projektin Energjia nga Linjiti është në zhvillim e sipër në bashkëpunim me planifikuesit e minierës. Çështja më kritike në këtë fazë është përgatitja e PVZH-së për fazën e minierës së Sibovcit.

Baza ligjore për shpronësime dhe zhvendosje mbetet Ligjin nr.03/L-139 për Shpronësimin e Zonës së Paluajtshme i cili është ende në fuqi. Qeveria e Kosovës edhe pas dy viteve të hyrjes së ligjit në fuqi nuk ka arritur të konsolidoj mirë organet për shpronësime dhe nuk ka nxjerrur udhëzimin administrativ për caktimin e kompensimit për shpronësimet e pronës së paluajtshme, ashtu siç parashihet me nenin 15 pika 6 të Ligjit për Shpronësime.

Fusha e Mihjes së Re përfshin një zonë prej 143,254 km<sup>2</sup> dhe brenda saj përfshihen 22 zona kadastrale të shtrira në katër komuna. Qeveria e Kosovës edhe pas dy viteve të hyrjes së ligjit në fuqi nuk ka arritur të konsolidoj mirë organet për shpronësime dhe nuk ka nxjerrur udhëzimin administrativ për caktimin e kompensimit për shpronësimet e pronës së paluajtshme

të interesit të veçantë ekonomik. Siç kemi shkruar edhe në GAP Monitor për mars 2009, Fusha e Mihjes së Re përfshin një zonë prej 143,254 km<sup>2</sup> dhe brenda saj përfshihen 22 zona kadastrale të shtrira në katër komuna.

Korniza e Politikave të Zhvendosjes (KPZh) bazohet

zhvendosja dhe kompensimi i banorëve është proces kompleks, ku kompensimi material nuk është i mjaftueshëm dhe se banorët e zhvendosur do të pësojnë dëme sociale (zhvendosje nga rrethi i tyre familjar dhe fqinjësor), ekonomike (humbja e klientelës për bizneset që mbyllen dhe ju duhet të operojnë në

## Qeveria kërkon nga Gjykata Kushtetuese sqarimin e imunitetit për zyrtarët e lartë publikë

Në mbledhjen e 24 të Qeverisë, më 20 korrik, Qeveria mori vendim (vendimi 09/24) që të kërkoj nga Gjykata Kushtetuese (GJK) të jap sqarime shtesë për domethënien e neneve të Kushtetutës së Republikës së

arsyetimin se kërkesa e EULEX nuk ka mbështetje ligjore dhe kushtetuese dhe kërkesë pranë GJK mund të ushtroj Qeveria. Qeveria në anën tjetër kishte refuzuar që të bëjë një kërkesë të tillë pranë GJK me arsyetimin

Presidentes/-it të Kosovës.

Në mbledhjen e 24 të Qeverisë, Kryeministri i ka njoftuar anëtarët e Qeverisë për përmbajtjen e kërkesave për GJK duke i falënderuar ata për aprovimin e vendimit, ende pa dalë propozimi në votim.

EULEX është duke zhvilluar hetime ndaj disa zyrtarëve të lartë publik. Kushtetuta e Kosovës, Rregullorja e Punës së Kuvendit dhe Ligji për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e deputetëve të Kuvendit të Kosovës përmbajnë dispozita për imunitetin e zyrtarëve të lartë publik.

Gjykata Kushtetuese ka marr vendimin e Qeverisë dhe pritet që mendimin e saj ta thotë në shtator të këtij viti. Ajo çfarë është kërkuar nga GJK është të jap sqarim se zyrtarët e lartë publik a gëzojnë imunitet edhe për veprat penale të kryera jashtë detyrës zyrtare.

Më parë Kryeministri kishte deklaruar se Qeveria nuk mund të kërkoj shpjegime nga GJK për imunitetin e deputetëve, ngase pushtetet janë të ndara

Kosovës që kanë të bëjnë me imunitetin e zyrtarëve të lartë publik.

Ky vendim u mor pas kërkesës që EULEX i kishte dërguar Kuvendit të Kosovës për të miratuar një rezolutë për imunitetin e deputetëve të Kosovës.

Kuvendi nuk kishte pranuar të marr një vendim të tillë me

se ekzekutivi nuk mund të kërkoj interpretim për çështje që kanë të bëjnë me legjislativin ngase pushtetet janë të ndara. Por, prapë se prapë Qeveria ka bërë një kërkesë të tillë. Por përveç kërkesës për sqarim të imunitetit të anëtarëve të Kuvendit të Kosovës, në kërkesë janë përfshi edhe sqarimet për imunitetin e zyrtarëve tjerë të lartë publik, si anëtarëve të Qeverisë dhe

Neni 75 i Kushtetutës së Kosovës bën fjalë për imunitetin e deputetit:

1. Deputetët e Kuvendit gëzojnë imunitet nga ndjekja penale, paditë civile ose shkarkimi për veprimet dhe vendimet e tyre brenda fushëveprimit të përgjegjësive të tyre si deputetë të Kuvendit. Imuniteti nuk pengon ndjekjen penale të deputetëve të Kuvendit për veprimet e ndërmarra jashtë fushëveprimit të përgjegjësive të tyre si deputetë të Kuvendit.
2. Deputeti i Kuvendit nuk mund të arrestohet dhe as ndalohet përderisa është duke kryer detyrat e tij/saj si deputet i Kuvendit, pa pëlqimin e shumicës së të gjithë deputetëve të Kuvendit.

Neni 81 i Kushtetutës së Kosovës bën fjalë për imunitetin e Presidentit të Republikës së Kosovës:

1. Presidenti i Republikës së Kosovës gëzon imunitet nga ndjekja penale, paditë civile ose shkarkimi për veprimet dhe vendimet brenda fushëveprimit të përgjegjësive të Presidentit të Republikës së Kosovës.

Neni 98 bën fjalë për imunitetin e anëtarëve të Qeverisë:

1. Anëtarët e Qeverisë së Kosovës gëzojnë imunitet nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimi për veprimet dhe vendimet brenda fushëveprimit të përgjegjësive të tyre si anëtarë të Qeverisë.

## Deri në fund të korrikut janë përzgjedhur 13 nga 19 sekretarët e përgjithshëm të ministrive

Në mbledhjet 22, 23 dhe 26 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të mbajtura me datë 6, 13 dhe 27 korrik, u emëruan edhe gjashtë sekretarë të përgjithshëm në: Ministrinë e Punëve të Jashtme (MPJ), Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR),

08/22, u emërua Arben Çitaku i cili edhe ishte u.d në po të njëjtën pozitë. Me vendimin 08/23, Zana Kotorri u emërua Sekretare të Përgjithshme në Ministrinë për Kthim dhe Komunitete e cila po ashtu që nga viti 2008 ishte u.d në po të njëjtën pozitë. Në qershor të këtij viti zyra e znj. Kororri dhe ato të MKK janë bastisur nga hetues të EULEX-

Në po të njëjtën mbledhje Qeveria emëroi edhe katër Kryeshefa të Agjencive të Pavarura. Kryeshef ekzekutiv në Agjencinë e Standardizimit në MTI u emërua Hafiz Gara, në Agjencinë për Promovimin e Investimeve në MTI u zgjodh Valdrin Lluka, në Agjencinë e Arkivave Shtetërore u zgjodh Ramë Manaj dhe kryeshef ekzekutiv për Mbështetje të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme në MTI u zgjodh Granit Berisha.

### Në korrik 2011, qeveria emëroi edhe gjashtë sekretarë të përgjithshëm të ministrive

Ministrinë për Kthim dhe Komunitete (MKK), Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB) si dhe në Ministrinë e Administratës Publike (MAP).

Konkursi për tri pozita të Sekretarëve të Përgjithshëm të MPJ, MKK dhe MMPH ishte shpallur më 9 qershor 2011, dhe qëndroi i hapur për 15 ditë kalendarike nga dita e publikimit. Mandati për pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm është i paraparë te jetë 3 vite, kurse paga mujore bruto 900.90 euro. Për pozitën e sekretaritë në MPB konkursi ishte shpallur më 16 qershor 2001, ndërsa në atë të MAP konkursi u shpall më 27 qershor 2011, me kohëzgjatje dhe pagë të njëjtë si në të gjitha konkurset e ministrive tjera.

Me vendimin 07/22, në postin e Sekretarit të Përgjithshëm në MPJ u emërua Nagip Skenderi. Z. Skenderi studimet universitare dhe ato pasuniversitare në fushën e ekonomisë i ka përfunduar në Universitetin e Prishtinës, kurse studimet për doktoraturë i ka ndjekur dhe përfunduar në Linc të Austrisë. Ai është edhe ligjërues në Universitetin e Prishtinës.

Në MMPH me vendimin

it, me dyshimin se në këtë Ministri janë zhvilluar aktivitete të kundërligjshme të korrupsionit.

Ndërsa me vendimin 07/23, në MBPZHR u emërua Kapllan Halimi, i cili që nga maji i vitit 2010 ishte u.d në këtë post. Z. Halimi më herët ka punuar në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Para se të shërbejë në shërbimin civil, z. Halimi ishte pjesë e ekipit zgjedhor të z. Hashim Thaçi në zgjedhjet parlamentare të 2007.

Dhe së fundi në mbledhjen e fundit të muajit korrik u

Ministria e Administratës Publike, e cili është përgjegjëse për organizimin e intervistave dhe përzgjedhjen e kandidatëve, nuk ka pranuar të ndajë me publikun emrat e anëtarëve të komisioneve vlerësuese për përzgjedhjen e sekretarëve të përgjithshëm. Procesi i gjertanishëm i përzgjedhjes së sekretarëve nuk ka garantuar emërimet jo partiake

përzgjedhjen edhe dy sekretarë të tjerë. Në MPB u zgjodh Ilhami Gashi, ndërsa në MAP u zgjodh Fitim Sadiku, i cili me profesion është jurist dhe i cili ka ushtruar postin e sekretarit të përhershëm që nga viti 2008.

Siç e kemi përmendur edhe në numrat e kaluar të GAP Monitor, përzgjedhja e sekretarëve të përgjithshëm dhe kryeshefave të agjencioneve bëhet në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregulloren Nr. 06/2010 për Procedurat e Emërimit në Pozita të Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil. Kurse, duke u bazuar në Rregulloren nr. 06/2010, komisioni për Vlerësimin e Kriteve

përbehet nga: tre sekretarë të përgjithshëm; një profesor fakulteti nga lëmi përkatës; dhe një anëtar nga shoqëria civile. MAP nuk ka dashur që të bëjë publike emrat e anëtarëve të këtyre komisioneve.



## Miratohet Plani Zhvillimor Strategjik i MMPH

**M**ë 27 korrik 2011, në mbledhjen e 26, Qeveria e Kosovës ka miratuar Planin Zhvillimor Strategjik të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor 2011-2014. MMPH është ministra e pestë për të cilën miratohet një plan i tillë zhvillimor tre vjeçar. Në 2009 dhe 2010, Qeveria ka miratuar planet zhvillimore strategjik edhe për këto ministri: Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB), Ministrinë e Administratës Publike (MAP), Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit (MPTP).

Plani Zhvillimor Strategjik për MMPH 2011-2014 vendos

tetë objektiva strategjike: 1. Përmirësimi i gjendjes në mjedis; 2. Menaxhimi i resurseve natyrore; 3. Fuqizimi i planifikimit hapësinor; 4. Regjistrimi i informatave për tokën; 5. Rregullimi i fushës së ndërtimit me rregulla teknike ndërtimore në harmoni me standardet e BE; 6. Rritja e qasjes në banim të përbalueshëm dhe të përshtatshëm për gjendjen ekonomike të familjeve dhe

ritja e vlerës së fondit banesor; 7. Fuqizimi i inspektoratit; dhe 8. Ndryshimet klimatike dhe mbrojtja nga rrezatimi.

Për të gjitha këto objektiva strategjike, janë paraparë edhe

masat për arritjen e tyre. Kurse me plan të veprimit janë paraparë edhe afatet kohore për realizimin e masave konkrete. Disa nga veprimet më të rëndësishme në tri vitet në vazhdim janë: Krijimi i Agjencisë për Mbrojtje nga Rrezatimi (2011); Vendosja e Sistemit të Monitorimit për Cilësinë e Ajrit (katër mujori i katërt i 2011); Krijimi i kushteve për miratimin e të gjitha konventave ndërkombëtare

Strategjia dhe Plani i Veprimit nuk përmban kostot buxhetore për aktivitetet e parapara

mjedisore (2014); Hartimi i Ligjit për Ekofondin (2011); Hartimi i strategjisë për ujërat (2012), etj.

Strategjia dhe Plani i Veprimit nuk përmban kostot buxhetore për aktivitetet e parapara.



# Miratohet Strategjia Kombëtare për Sigurinë në Bashkësi dhe Plan i Veprimit 2011-2016

Qeveria e Kosovës, në mbledhjen e saj të 23, të mbajtur më 13 korrik 2011, miratoi Strategjinë Kombëtare dhe Planin e Veprimit për Sigurinë në Bashkësi 2011-2016.

Ky dokument është i një rëndësie të posaçme pasi që mundëson strukturave të sigurisë që të jenë më afër qytetarit për ta bërë atë më të sigurt. Gjithashtu, kjo strategji siguron bashkërendim me strategjitë e tjera të miratuara më parë nga Qeveria si: Strategjia Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore, Strategjia për Parandalimin e Krimit, Strategjia kundër Drogave, Terrorizmit, Krimit të Organizuar, Migracionit dhe Strategjia për Sigurinë Kombëtare. Strategjia mundëson krijimin e partneriteteve komunale dhe zbatimin e objektivave kombëtare në nivel komunal.

Strategjia Kombëtare dhe Plan i Veprimit për Sigurinë në Bashkësi 2011-2016 i trajton nevojat e Kosovës dhe këto nevoja i ka të ndara në pesë synime strategjike dhe gjashtë objektiva specifike:

- **Synimi strategjik 1** – shkalla e besimit publik në institucionet qeveritare dhe të sigurisë është në ngritje të vazhdueshme.
  - » **Objektivi specifik 1** – Institucionet Qeveritare dhe të Sigurisë janë pro-aktive dhe kanë të zhvilluara programe parandaluese.
  - » **Objektivi specifik 2** – Garantimi gjithëpërfshirës dhe pjesëmarrës i qytetarëve në forumet e sigurisë (KKSB, EVSB, KLSP) përfshirë shoqërinë civile në adresimin adekuat të nevojave nga institucionet.
  
- **Synimi strategjik 2** – Cenimi i Sigurisë Publike, Personale dhe të Pronës është në shkallë të ulët.
  - » **Objektivi specifik 1** - Niveli i krimit, i konflikteve ndërmjet grupeve të ndryshme dhe i pakënaqësive publike është i ulët (nivel i pranueshëm).
  - » **Objektivi specifik 2** - Metodologjia e punës së policisë së Kosovës bazohet në konceptin e policimit në bashkësi.

- **Synimi strategjik 3** - Kthimi dhe ri-integrimi i qytetarëve nuk paraqitet si sfidë teknike për liberalizimin e vizave apo në integrimin e Republikës së Kosovës në Bashkimin Evropian.
  - » **Objektivi specifik 1** - Institucionet komunale dhe forumet e sigurisë ndihmojnë në integrimin e qytetarëve të kthyer.

- **Synimi strategjik 4** - Çështjet e ndërlidhura me komunitetet jo-shumicë adresohen në mënyre adekuate dhe institucionale.
  - » **Objektivi specifik 1** - Komunitetet jo-shumicë marrin pjesë aktivisht në mekanizmat e sigurisë në bashkësi.

- **Synimi strategjik 5** – Forumet e sigurisë ndihmojnë intensivisht në implementimin e strategjive nacionale në nivelin lokal.
  - » **Objektivi specifik 1**- Koordinimi ndër-institucional dhe bashkëpunimi ndërmjet mekanizmave të ndryshëm për të lehtësuar zbatimin e strategjive nacionale në nivel lokal.

- **Synimi strategjik 6** - Ngritja e vetëdijes së qytetarëve dhe koordinimi i akterëve në nivel lokal dhe qendror për përmirësimin e sigurisë publike.
  - » **Objektivi specifik 1** - Harmonizimi i planeve të veprimit mes planit për siguri në shkolla, atij operacional të PK-së dhe KKS-së.
  - » **Objektivi specifik 2** - Sensibilizimi i qytetarëve për rëndësinë e promovimit të bashkëpunimit ndër-etnik, multi-kulturor dhe ndër-fetarë.
  - » **Objektivi specifik 3** - Vetëdijesimi i qytetarëve të Republikës së Kosovës për kërcënimet globale të sigurisë.

- **Synimi strategjik 7** - Parandalimi dhe zvogëlimi i krimit në bashkësi.
  - » **Objektivi specifik 1**- Fuqizimi kapaciteteve njerëzore të institucioneve dhe forumeve tjera të sigurisë që merren me parandalimin e krimit.
  - » **Objektivi specifik 2** - Ngritja e vetëdijesimit të bashkësisë për rrezikun nga përdorimi i narkotikëve.
  - » **Objektivi specifik 3** - Ngritja e vetëdijesimit të bashkësisë mbi çështjet e trafikimit me qenie njerëzore.

- **Synimi strategjik 8** – Tranzicioni i suksesshëm i EVSB
  - » **Objektivi specifik 1**- Tranzicioni i suksesshëm i EVSB-ve nga ICITAP tek MPB.
  - » **Objektivi specifik 2** - Krijimi dhe revitalizimi i forumeve të sigurisë në bashkësi.

- **Synimi strategjik 9** - Institucionet e sigurisë janë të afta për t'iu përgjigjur kërcënimeve që mund të vijnë nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera dhe ekzistojnë plane për reagim dhe rimëkëmbje pas fatkeqësisë.
  - » **Objektivi specifik 1**- Promovimi i sjelljeve dhe veprimeve të sigurta për parandalim, gatishmëri, reagim dhe rimëkëmbje, nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera që mund të shkaktojnë rrezik për jetën, të mirat materiale, infrastrukturën, trashëgiminë kulturore dhe ambientin.
  - » **Objektivi specifik 2** - Vlerësimi i rreziqeve, identifikimi, aftësimi dhe monitorimi i strehimoreve.

Përpos synimeve dhe objektivave strategjike të pasqyruara në këtë strategji, është paraparë edhe zbatimi, mbikëqyrja dhe vlerësimi i këtij të fundit.

Dimensionet kryesore të mbikëqyrjes dhe vlerësimit të strategjisë janë:

1. Kapacitetet institucionale;
2. Treguesit e monitorimit përgjatë dhe në fund të periudhës pesë vjeçare;
3. Burimet e informacionit dhe instrumentet matëse;
4. Shpërndarja dhe përdorimi i rezultateve të monitorimit dhe vlerësimit.

Siç u cek në fillim, krahas strategjisë, Qeveria ka miratuar dhe Planin e Veprimit. Ky plan ka paraparë objektivat, aktivitetet që do të ndërmerren përgjatë periudhës 5 vjeçare, institucionet relevante të cilat do të jenë përgjegjëse për ndërmarrjen e aktiviteteve të parapara, afatet kohore, buxheti i cili pritët të jetë 232 mijë euro, si dhe treguesit.

Më shpejtë, më lehtë:  
**GAP MONITOR**  
n'internet



[www.gapmonitor.org](http://www.gapmonitor.org)





Jeton Mehmeti

## Përse shumë biznese private ende nuk e zbatojnë Ligjin e Punës?!

E drejta për të punësuar nuk nënkupton edhe të drejtën për të abuzuar. Andaj, punëtori meriton më shumë se sa kompensimin material që merr, ai/ajo meriton edhe respektin sepse këtu vjen në shprehje respektimi i dinjitetit të një individi.

**P**o bëhen më shumë se gjashtë muaj që kur ligji i punës ka hyrë në fuqi dhe shumë punëdhënës jo që nuk po e zbatojnë atë por ende nuk e kanë lexuar se çfarë dispozitash përmban ai. Shumë biznese private, kryesisht të vogla dhe të mesme, vazhdojnë të operojnë sipas 'ligjeve' që ka vënë pronari. Punëtori në anën tjetër, i kënaqur (por jo edhe i lumtur) që ka siguruar një vend pune, as që përpqet të kërkojë të drejtat e tij-saja siç i parasheh ligji, shpesh me frikën se mos duke kërkuar të drejtat e punës do ta humb edhe vetë vendin e punës. Edhe ky, sikurse punëdhënësi, ende nuk e ka lexuar ligjin e punës.

Javë më parë Instituti GAP publikoi një analizë rreth zbatimit të ligjit të punës në gjashtë mujorin e parë. Gjatë hulumtimeve tone dëgjova për shkelje të ndryshme të të drejtave të punëtorëve në sektorin privat. Dëgjova se si punëtori i ndërtimtarisë punonte dhjetë orë në ditë, shtatë ditë në javë, pa masa mbrojtëse të punës dhe pa kontratë pune. Dëgjova se si orari i kamerierit fillonte nga ora tetë e mëngjesit dhe përfundonte në daljen e mysafirit të fundit diku para mesnatës. Një farmacistë nuk ankohej sepse punonte me 'orar të rregullt', pra tetë orë në ditë kurse të dielën e kishte pushim. Një djalosh më tregonte se kishte mbi katër vite që punonte në një qumështore dhe krejt çfarë pronari i kishte dhënë pushim vjetor deri më sot ishin dhjetë ditë kur ishte martuar. Edhe ky nuk ankohej sepse ashtu ishin marrë vesh në fillim.

Nuk u befasova përse po ndodhnin shkelje të tilla të të drejtave të punëtorit, por u befasova se si për shumë punëdhënës këto nuk paraqisnin kurrfarë shkeljesh. Dhe pikërisht këtu nis problemi; shkelja e ligjit na është bërë normalitet, kurse respektimi i tij sensacion. Dikush thoshte se në një shtet ku e drejta e njeriut për të pasur një vend pune nuk garantohet, të drejtat e atij që punon mund të konsiderohen luks. Por a është e drejtë dhe e moralshme që punëdhënësi të privojë punëtorin nga të drejtat e tij legjitime? Aq më tepër kur në shumë biznese private punësohen njerëz të afërt, me ç'rast bëhen dy shkelje, edhe si punëtorë edhe si mik i familjes. Në përgjithësi pagat në sektorin privat janë shumë të ulëta. Këtu mund t'i kuptoj punëdhënësit deri diku. Por, nuk mund të kuptoj përse punëtori nuk ka kontratë pune, përse detyrohet të punojë më shumë se dyzet orë në javë, përse të mos ketë katër javë pushim vjetorë, apo pushim mjekësor deri në dyzet ditë? Çfarë do të humbiste një biznes sikur punëtorit të punonte pesë ditë në javë dhe dy të tjerat t'i kalojë me familjen? Le të punësojë njerëz shtesë me orar të shkurtër nëse ai lloj biznesi kërkon operim shtatë ditë në javë. Shumë pronar hotelesh e restorantesh, barnatoresh e firmash ndërtimore krenohen me numrin e punëtorëve që kanë, por sa janë punëtorët krenar me punëdhënësit e tyre? E drejta për të punësuar nuk nënkupton edhe të drejtën për të abuzuar. Andaj, punëtori meriton

më shumë se sa kompensimin material që merr, ai/ajo meriton edhe respektin sepse këtu vjen në shprehje respektimi i dinjitetit të një individi. Edhe më tutje bizneset më shumë respektojnë manualin e përdorimit të makinave të punës, se sa të drejtat ligjore të punëtorëve.

Akademikët shpjegojnë se një ndër arsyet përse një qeveri duhet të ndërhyjë në tregun e punës duke nxjerrë ligje për ta rregulluar atë është se tregjet e punës nuk janë të përsosura dhe si pasojë punëdhënësit përmes fuqisë së tregut që e kanë i keqpërdorin punëtorët duke shpënë në padrejtësi dhe joeficiencë. Sot, kur e kemi ligjin e punës duhet ta respektojmë atë. Zbatimi i ligjit kërkon angazhimin e punëdhënësit, punëmarrësit dhe inspektoratit të punës. Punëdhënësi duhet të njihen me dispozitat që parasheh ligji i punës, me obligimet që ka ndaj punëmarrësit dhe me dispozitat ndëshkuese që parasheh ligji në rast të shkeljes së të drejtave të punëmarrësit. Punëdhënësit duhet ta kenë parasysh se për mungesë të kontratës mund të ndëshkohet deri në 1000 euro, puna më e gjatë se orari i plotë i punës ndëshkohet deri në 5000 euro sikurse edhe mos dhënia e pushimit vjetor, kurse mos dhënia e pushimit të lehonisë me pagesë ndëshkohet deri në 10,000 euro. Punëmarrësit në anën tjetër gjithashtu duhet ta lexojnë ligjin e punës të cilin mund ta gjejnë lehtë në ueb faqen e Kuvendit të Kosovës dhe në Gazetën Zyrtare. Institucionet publike qendrore dhe komunale duhet t'i shpërndajnë çdo

pronari të ri të biznesit një kopje të Ligjit të Punës. Punëtorët duhet të lexojnë për të drejtat e tyre, se si duhet të duket kontrata e punës, sa mund të zgjasë puna provuese, sa duhet të jetë orari i punës, çfarë page shtesë i takon atij që punon në ndërrimin e natës, në ditë të festave e në fundjavë, sa zgjatë pushimi vjetorë apo pushimi me rastin e martesës, vdekjes së një familjari, lindjes së fëmijës, si ndahet pushimi i lehonisë për femrat, etj. Punëtori gjithashtu duhet ta dijë se në rast se punëdhënësi ia mohon këto të drejta, ligji i garanton mbrojtje pasi të ketë paraqitur ankesë në gjykatë apo pranë inspektoratit të punës. E inspektorët e punës duhet të jenë sa më prezent në terren, të dëgjojnë ankesat e punëtorëve dhe të jenë të pa kompromis ndaj atyre që shkelin ligjin e punës dhe të drejtat e punëtorëve. Është e vërtetë se inspektorët nuk gëzojnë kushte optimale për punë, por prapë se prapë mbetet obligim i tyre ligjor që ta monitorojnë zbatimin e ligjit të punës, derisa punëdhënësit të vetëdijesohen se të respektosh të drejtat e punëtorit do të thotë të përmbushësh një obligim ligjor dhe moral.

Akademikët shpjegojnë se një ndër arsyet përse një qeveri duhet të ndërhyjë në tregun e punës duke nxjerrë ligje për ta rregulluar atë është se tregjet e punës nuk janë të përsosura dhe si pasojë punëdhënësit përmes fuqisë së tregut që e kanë i keqpërdorin punëtorët



3. Vendimet nga mbledhja e 24 e Qeverisë së Kosovës, mbajtur më 20 korrik 2011:
  - 3.1 Vendimi 02/24, miratohet Plani i Veprimit për Strategjinë e Sigurisë së Republikës së Kosovës
  - 3.2 Vendimi 03/24, miratohet Vendimi për emërimin e Komisionit për Menaxhimin e Fondit për Mbështetje të Mediave Minoritare, Multietnike dhe Grupeve Tjera të Veçanta;
  - 3.3 Vendimi 04/24 Miratohet Vendimi për Emërimin e Kandidatëve në Bordet e Përkohshme të TrainKos-it dhe InfraKos-it;
  - 3.4 Vendimi 05/24, miratohet Udhëzimi Administrativ për Normat e Cilësisë së Ajrit;
  - 3.5 Vendimi 06/27, miratohet Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin;
  - 3.6 Vendimi 07/24, miratohet Vendimi për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit për listën e importit të barnave dhe produkteve medicinale;
  - 3.7 Vendimi 08/24, Qeveria e Republikës së Kosovës i referon Gjykatës Kushtetuese parashtresë për sqarim lidhur me imunitetin e anëtarëve të Qeverisë, për veprimet e marra jashtë fushëveprimit të përgjegjësive të tyre;
  - 3.8 Vendimi 09/24, Qeveria e Republikës së Kosovës i referon Gjykatës Kushtetuese parashtresë për sqarim lidhur me imunitetin e deputetëve të Kuvendit të Kosovës, për veprimet e marra jashtë fushëveprimit të përgjegjësive të tyre;
  - 3.9 Vendimi 10/24, Qeveria e Republikës së Kosovës i referon Gjykatës Kushtetuese parashtresë për sqarim lidhur me imunitetin e Presidentit, për veprimet e marra jashtë fushëveprimit të përgjegjësive të tyre;
4. Vendimet nga mbledhja e 25 e Qeverisë së Kosovës, mbajtur më 22 korrik 2011:
  - 4.1 Vendimi 02/25, miratohet Projektligji për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjarëve të tyre;
5. Vendimet nga Mbledhja e 26-të e Qeverisë së Kosovës, mbajtur më 27 korrik 2011
  - 5.1 Vendimi 02/26, miratohet Projektligji për Qendrën Historike të Prizrenit;
  - 5.2 Vendimi 03/26, miratohet vendimi për Reduktimin e Alokimeve të Shpenzimeve;
  - 5.3 Vendimi 04/26, miratohet Projektligji për Lirinë e Asociimit në Organizata Jo-Qeveritare;
  - 5.4 Vendimi 05/26, miratohet Projektligji për Organizmat e Modifikuar Gjenetiki;
  - 5.5 Vendimi 06/26, miratohet Raporti Gjashtëmujor i Buxhetit 2011;
  - 5.6 Vendimi 07/26, miratohet vendimi për ndarjen e mjeteve financiare në vlerë prej 60,000 euro për Auditorin e Përgjithshëm;
  - 5.7 Vendimi 08/26, miratohet Plani Zhvillimor Strategjik 2011-2014 i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor;
  - 5.8 Vendimi 09/26, miratohet vendimi për emërimin e sekretarëve të përgjithshëm në MPB dhe MAP;
  - 5.9 Vendimi 10/26, miratohet vendimi për vazhdimin e Master Planit për Brezovicën;
  - 5.10 Vendimi 11/26, miratohet vendimi për Plotësimin dhe Ndryshimin e vendimit nr. 11/12 të datës 27.04.2011.

korrik 2011

# gap | monitor

i vendimeve të Qeverisë së Kosovës

GAP Monitor është publikim i përmuajshëm monitorues i vendimeve të Qeverisë i përgatitur nga Instituti për Studime të Avancuara GAP. Në këtë numër kanë kontribuar Agron Demi, [agron@institutigap.org](mailto:agron@institutigap.org); Rudina Heroi, [rudina@institutigap.org](mailto:rudina@institutigap.org); Antigona Berisha, [antigona@institutigap.org](mailto:antigona@institutigap.org); Ilir Bajraktari dhe Kreshnik Berisha.

GAP Monitor botohet në kuadër të projektit të Monitorimit të Qeverisë, në kuadër të të cilit është krijuar edhe faqja e internetit [www.gapmonitor.org](http://www.gapmonitor.org), ku mund të gjenden të gjitha raportet monitoruese të vendimeve të Qeverisë pak ditë pas marrjes së vendimeve.

INSTITUTI PËR STUDIME TË AVANCUARA



Instituti GAP është Think Tank kosovar, që punon në ngushtimin e hendekut në mes qeverisjes dhe qytetarëve të Kosovës, në shërbim të avancimit të shoqërisë kosovare.

Rr. Nëna Terezë 41/29, 10000 Prishtinë, Kosovë | +381 38 224 145  
[monitor@institutigap.org](mailto:monitor@institutigap.org) | [www.gapmonitor.org](http://www.gapmonitor.org) | [www.institutigap.org](http://www.institutigap.org)

Instituti GAP përkrahet nga:



Opinionet e shprehura në këtë dokument janë ato të Institutit GAP dhe jo medoemos reflektojnë pikëpamjet e donatorëve të këtij projekti.